



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REP. E KOSOVES QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGJIE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njesia Org. Org.Jedinica Org Unit	01/B
Nr. i faqeve Br. stranic No. pages	2
Nr. Prot: Broj Prot: Prot.No:	1828
Data: Datum: Date:	28.03.2023

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation
Kabineti i Ministres/Kabinet Ministarke/Cabinet of the Minister

Numër: 01B-035

Data: 28.03.2023

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, shtojca 1 paragrafi 7 i Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 30.03.2021, nxjerr këtë:

VENDIM

Për përtëritjen e dokumentacionit pedagogjik të asgjësuar nga lufta

1. Procedura për përtëritjen e dokumentacionit pedagogjik të asgjësuar nga lufta iniciohet në bazë të kërkesës me shkrim të ish nxënësit/kandidatit ose përfaqësuesit të tij ligjor.
2. Nxënësi ose përfaqësuesi i tij ligjor e shkruan deklaratën me shkrim në libër të posaçëm për deklarata të cilin e mban shkolla dhe e nënshkruan në prani të drejtorit të institucionit arsimor - shkollës, e cila duhet të përfshijë:
 - 2.1. Periudhën e shkollimit;
 - 2.2. Suksesin;
 - 2.3. Vitin e diplomimit;
 - 2.4. Emrin e kujdestarit ose mësuesit;
 - 2.5. Fjalën "Garantoj moralisht e materialisht se deklarata është e saktë".
3. Deklaratën për ish nxënës/kandidat të shkollës fillore e jep përfaqësuesi ligjor, ndërsa për shkolla të mesme e jep vet kandidati.
4. Për përtëritjen e dokumentacionit pedagogjik të asgjësuar nga lufta duhet të bëhet evidentim i posaçëm pedagogjik në dokumentet si në vijim:
 - 1.1. Libri amë;
 - 1.2. Libri i protokollit;
 - 1.3. Regjistri i diplomave të lëshuara;
 - 1.4. Libri i deklaratave;
5. Dokumentacioni pedagogjik i përtërirë, duhet të protokollohet dhe të shënohet në dokumentacion numri i këtij vendimi, të nënshkruhet dhe të vuloset nga drejtori i institucionit arsimor - shkollës.

6. Për shqyrtimin e kërkesës për përtëritjen e dokumentacionit pedagogjik të asgjësuar nga lufta, drejtori i institucionit arsimor – shkollës, emëron Komisionin në përbërje prej 3 anëtarëve për zhvillimin e procedurave, vlerësimin dhe vendosjen për dokumentin.

7. Detyrat e komisionit janë:

- 7.1. Të konstatojnë periudhën e shkollimit të nxënësit/kandidatit;
- 7.2. Të konstatojnë shkallën e shkollimit të nxënësit/kandidatit;
- 7.3. Të konstatojnë vitin e diplomimit të nxënësit/kandidatit;
- 7.4. Të konstatojnë suksesin e përafërm të nxënësit/kandidatit.

8. Në librin e konstatimeve përshkruhet sukcesi i përgjithshëm si në vijim:

- 8.1. Mjaftueshëm (2);
- 8.2. Mirë (3);
- 8.3. Shumë Mirë (4);
- 8.4. Shkëlqyeshëm (5).

9. Nëse komisioni konstaton se kandidati nuk e ka mbaruar vitin-shkollimin me sukses, e bën këtë me shkrim në libër amë dhe e njofton palën me shkrim për arsyet e mos lëshimit të dokumentit.

10. Kundër njoftimit të komisionit është e lejuar ankesa në afat prej 8 ditësh në Komisionin për ankesa në Komunën përkatëse.

11. Dokumentacioni pedagogjik arkivohet dhe ruhet në arkivin e shkollës në përputhje me rregullat e arkivit.

12. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIMI

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, për shkak të kërkesave të shumta për përtëritjen e dokumentacionit pedagogjik të asgjësuar nga lufta, bazuar në nevojën për nxjerrjen e një akti që rregullon këtë procedurë, u vendos si në dispozitiv të këtij emërimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministres / MASHTI;
2. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm / MASHTI;
3. DKA-ve;
4. Departamentit të arsimit parauniversitar;
5. Departamentit të arsimit profesional;
6. Departamentit ligjor;
7. Arkivit /MASHTI.

